

Maloku në Hagë: Është e vështirë ta kuptosh UÇK-në, u ngrit prej popullit të robëruar




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KENIA, NJË NDËR SHTETET MË TË RËNDËSISHME TË AFRIKËS,
NJEH ZYRTARISHT SHTETIN E KOSOVËS

KENIA NJEH PAVARËSINË E KOSOVËS



Kenia ka njohur zyrtarisht shtetin e Kosovës. Lajmin e ka dhënë ish-presidenti dhe ish-kryediplomati Behgjet Pacolli, i cili ka thënë se kjo njohje nuk është thjesht një deklaratë, por fitore e madhe për shtetin e Kosovës. Ai ka thënë se zëri i lirisë së Kosovës do të

dëgjohej thellë në zemrën e Afrikës. Pacolli ka vlerësuar se kjo fitore diplomatike nuk ka ndodhur rastësisht, duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës të vendosë menjëherë marrëdhënie diplomatike me shtetin e Kenias. Ndërsa në emër të institucioneve

dhe të qytetarëve të Kosovës, presidentja Vjosa Osmani ka shprehur falënderime ndaj presidentit të Kenias, William Ruto, për vendimin për njohjen e shtetit tonë. Po ashtu, Osmani ka falënderuar edhe Pacollin për kontributin për këtë njohje

KATËR VRASJET NË TRI DITËT E FUNDIT, KRASNIQI: SHTETI TË ZGJOHET URGJENTISHT, KONTROLL I RREPTË I ARMËVE



MASAKRA E KRUSHËS SË MADHE, DËSHMI E MIZORISË SË REGJIMIT GJENOCIDAL TË MILLOSHEVIQIT



OPINION

ALBIN ZHDANOVI! F. 8

Shkruan: Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA



AKTUALE



KURTI: USHTRISË DO T'IA NDAJMË MBI 1 MILIARD EURO, DO TË BLEJMË HELIKOPTERË 'BLACK HAWK' F. 3

SUPREMJA RRËZON ANKESËN E LV-së PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE, HAPET RRUGA PËR CERTIFIKIMIN E TYRE F. 5

PROKURORIA NIS HETIMET PËR VOTIMIN ME POSTË F. 5

EKONOMI



RRITJE TË PAGËS MINIMALE MBI 500 EURO DHE 100 MILIONË EURO PËR BARNAT ESENCIALE, QEVERIA SHPALOS PLANET PËR TË ARDHMEN F. 8

I DYSHUARI PËR RASTIN E REZERVAVE SHTETËRORE, IRFAN LIPOVICA EMËROHET DREJTOR I AKREDITIMIT NË MINT F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kosova dhe Serbia ua ndalojnë hyrjen ministrave të njëra-tjetrës

PRISHTINË, 26 MARS - Serbia ia ka ndaluar vizitën ministrit të Kulturës të Kosovës, Hajrulla Çeku, në Preshevë. Me masë të njëjtë ka vepruar edhe Kosova, duke ia ndaluar vizitën në Kosovë, ministrit serb të Shëndetësisë, Zllatibor Llonçar. Kryetarja e Preshevës, Ardita Sinani, ka thënë se kjo është hera e dytë që ministrit Çeku i ndalohet ta vizitojë Preshevën, një nga tri komunat në jug të Serbisë të banuar me shqiptarë. Sinani i ka akuzuar autoritetet në Serbi se fshihen “pas një fasade pro-evropiane”, por vendime të tilla, sipas saj, janë “akt i politikës nacionaliste serbe”. Qeveria e Kosovës ende nuk ka

reaguar lidhur me ndalimin e vizitës së Çekut, po as Serbia nuk ka dhënë ndonjë arsye për këtë. Ndërsa ministri i Shëndetësisë i Serbisë, Zllatibor Llonçar, po ashtu, ka njoftuar se autoritetet në Kosovë ia kanë ndaluar kërkesën për vizitë në Graçanicë dhe Mitrovicë të Veriut. Ai ka thënë se ka synuar të takohet me punëtorët shëndetësorë në institucionet shëndetësore serbe – që konsiderohen ilegale në Kosovë. Ai e ka akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se me këto ndalesa të vizitave “drejtpërdrejt po minon normalizimin e raporteve”.



Çështja e vizitave zyrtare në mes të Kosovës dhe Serbisë rregullohet përmes një marrëveshjeje të arritur në kuadër të dialogut për normalizim të raporteve që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.



Vizitat duhet të paralajmërohen përmes zyrtarëve ndërlidhës të Kosovës dhe Serbisë. Më pas, autoritetet në shtetet përkatëse duhet t'i autorizojnë ato. Vitet e fundit si Kosova ashtu edhe Serbia kanë refuzuar

kërkesat për vizita të zyrtarëve qeveritarë, por edhe të figurave fetare, teksa raportet mes dy vendeve janë të tensionuara. Tensionet janë përshkallëzuar qysh në prill të vitit 2023, kur u zgjodhën kryetarët e rinj shqiptarë të katër komunave në veri të banuara me shumicë serbe. Tensionet kulmuan shtatorin e atij viti, kur një grup i serbëve të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke vrarë një rreshter. Po ashtu, vitin e kaluar kanali i Ibër-Lepencit në veri u sulmua me mjete plasëse. Për sulmet, Kosova ka fajësuar Serbinë, por Beogradi ka mohuar se ka gisht në to.

Urdhri ekzekutiv i Trumpit: Në qendrat e votimit, vetëm me pasaportë

UASHINGTON, 26 MARS - Presidenti amerikan Donald Trump ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv që do të sjellë ndryshime thelbësore në ligjin zgjedhor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Sipas rregullave të reja, të gjithë votuesit në ShBA do të jenë të detyruar ta provojnë nënshkrimin e tyre nëpërmjet pasaportave në qendrat e votimit. Urdhri ekzekutiv i nënshkruar nga



Trumpi përcakton se votat me postë që mbërrijnë pas ditës së zgjedhjeve do të quhen të

pavlefshme dhe nuk do të numërohen. Ky vendim është në përputhje me qëndrimet që Donald Trumpi kishte shprehur prej kohësh, duke iu referuar veçanërisht zgjedhjeve të vitit 2020 kundër Joe Bidenit. Donald Trumpi vazhdon të thotë se ato zgjedhje presidenciale “iu vodhën”, megjithatë deri më tani nuk ka pasur asnjë prove për diçka të tillë.

Ekspertët paralajmërojnë se ndryshimet e miratuara mund të pengojnë miliona amerikanë të votojnë. Statistikat tregojnë se rreth 146 milionë qytetarë nuk kanë pasaportë, ndërsa nëntë për qind e popullsisë nuk ka dokumente të gatshme që dëshmojnë shtetësinë. Shtëpia e Bardhë ka mbrojtur vendimin, duke argumentuar se masat synojnë ta parandalojnë votimin e

emigrantëve të paligjshëm. Megjithatë, hetimet kanë treguar se ky fenomen është i rrallë dhe nuk ka ndikuar në rezultatet zgjedhore. Për më tepër, urdhri i Trumpit i jep qeverisë federale të drejtën t'i ndalojë financimet për shtetet që nuk zbatojnë rregullat e reja. Megjithatë, ky vendim pritet të përballlet me sfida ligjore dhe mund të përfundojë në Gjykatën e Lartë.

ShBA-ja thotë se Rusia dhe Ukraina pajtohen për t'i ndaluar sulmet në Detin e Zi

UASHINGTON, 26 MARS - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë bërë me dije se kanë arritur marrëveshje ndaras me Ukrainën dhe Rusinë për të garantuar lëvizje të lirë të anijeve komerciale në Detin e Zi, dhe për të zbatuar një ndalesë në sulmet ndaj objekteve të energjisë së njëra-tjetrës. Shtëpia e Bardhë ka thënë se marrëveshjet do t'i rikthejnë Moskës qasjen në tregjet globale për eksportet e produkteve bujqësore, të cilat janë bllokuar prej nisjes së luftës. Marrëveshjet, nëse

zbatohen, do të përbëjnë përparimin të madh drejt një armëpushimi më të gjerë që Uashingtoni e konsideron shumë të rëndësishëm në bisedimet për paqe, që do t'i jepnin fund luftës trevjeçare të Rusisë në Ukrainë. Rusia, megjithatë, ka thënë se nuk i beson presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky dhe do të nënshkruajë një marrëveshje për Detin e Zi, nëse Uashingtoni i lëshon “urdhër” atij për ta respektuar ujdinë. “Neve na duhen garanci të qarta. Marrë parasysh përvojën

e hidhur të marrëveshjeve vetëm me Kievin, garancitë mund të jenë vetëm rezultat i një urdhri prej Uashingtonit ndaj Zelenskyt dhe ekipit të tij që të bëjë një gjë dhe jo një tjetër”, ka thënë ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov në disa komente televizive. Ministri ukrainas i Mbrojtjes, Rustem Umerov, ka thënë se Kievi është pajtuar me marrëveshjet, dhe që do t'i mirëpresë shtetet e treta që të mbështesin zbatimin e tyre. Megjithatë, ai ka thënë se Kievi do ta konsiderojë secilën lëvizje të anijeve ruse përtej

zonës lindore të Detit të Zi si shkelje të shpirtit të marrëveshjeve, dhe në atë rast, vendi i tij do të ketë të drejtën e vetëmbrojtjes. Moska ka nisur vazhdimisht raketa dhe dronë në linjën e frontit në Ukrainë, prej nisjes së luftës në shkurt të vitit 2022, duke shënjestruar centralet ukrainase të energjisë, dhe objektet për prodhim të gazit natyror. Ukraina, në anën tjetër, ka nisur dronë luftarakë me rreze të gjatë për të sulmuar infrastrukturën ruse të naftës, siç janë rafineritë.



Uashingtoni ka lëshuar deklarata të ndara për media, pasi zyrtarët amerikanë janë takuar me përfaqësues të të dyja shteteve në Arabinë Saudite në ditët e fundit. Disa takime kanë zgjatur mbi 12 orë.

Danimarka vendos shërbimin e detyrueshëm ushtarak për gratë

KOPENHAGË, 25 MARS - Danimarka ka vendosur shërbimin e detyrueshëm ushtarak për gratë. Nga viti 2026 e në vazhdim gratë mund të thirren për shërbim ushtarak. Kjo masë synon ta rrisë aftësinë mbrojtëse të vendit. Danimarka do të shtojë

numrin e rekrutëve për ushtrinë daneze dhe për Agjencinë daneze të Mbrojtjes Civile. Nga rreth 4 700 vetë tani, ky numër duhet të shkojë në 7 500 vetë. Prandaj ministri danez i Mbrojtjes, Troels Lund Poulsen, ka thënë se duke nisur nga viti 2026 gratë duhet të kryejnë shërbimin e

detyruar ushtarak në të njëjtat kushte si burrat. Ai ka thënë se nëse për shërbimin e detyruar ushtarak nuk paraqitet një numër i mjaftueshëm vullnetarësh, gratë mund të rekrutohen edhe me detyrim. Sipas këtij vendimi, vajzat që mbushin 18 vjeç pas 1 korrikut të këtij viti

mund të rekrutohen për shërbim ushtarak gjatë vitit 2026. “Barazia është e mirë dhe rrit mundësinë e ndërtimit të fuqisë luftarake në mbrojtjen daneze”, ka thënë ministri për të përditshmen daneze “Jyllands-Posten”. Në Danimarkë shërbimi i detyrueshëm ushtarak

zbatohet deri tani vetëm për burrat e moshës 18 vjeç e lart. Për gratë deri sot shërbimi ushtarak nuk është i detyrueshëm, por ato mund të regjistroheshin vullnetarisht për të marrë pjesë në këtë shërbim. Gratë përbëjnë 25 për qind të rekrutëve të ushtrisë daneze.

MALOKU NË HAGË: ËSHTË E VËSHTIRË TA KUPTOSH UÇK-në, USHTRI QË U NGRIT PREJ POPULLIT TË ROBËRUAR


HAGË, 26 MARS - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë, dëshmitari Naim Maloku ka deklaruar se është e vështirë të kuptohet funksionimi i një ushtrie që është ngritur nga populli i robëruar siç ka qenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Këtë deklaram Maloku e ka bërë të mërkurën, në ditën e tretë të dëshmisë në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, raporton “Betimi për Drejtësi”. “Është vështirë me e kuptuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Është vështirë me e kuptuar një ushtri që ngritet prej një populli të robëruar, në ushtri vullnetare, në ushtri të rregullt. Kjo ka qenë që na ka bërë bashkë, qëllimi ynë për çlirim të Kosovës”, ka thënë Maloku duke u përgjigjur në pyetjet e avokatit të Veselit, Rodney Dixon.

Kur është pyetur për Mensur Kosumin, Maloku ka thënë se nuk e ka ditur që personi në fjalë ka qenë shef i zbulimit. “Me tregu të drejtën, për pozitën e tij që e ka pasur si shef zbulimi nuk e kam ditë”, ka thënë Maloku.

Dëshmitari, të martën, për prokurorinë ka thënë se Faton Mehmetaj ka qenë epror i Sektorit të Zbulim-Kundërzbulimit në Zonën e Dukagjinit. “Në ato njësi ku kam qenë, në ato takime dhe ato inspektime që i kam bërë, unë nuk e kam pa atë kurrë që të marrë pjesë. Ai ka pas punë tjetër... Nuk kam has kurrkund me punët që ka pas Faton Mehmetaj. Nuk ka pas pikë-kryqëzim askund”, ka thënë Maloku për Mehmetajn.

Dëshmitarit i është paraqitur edhe deklarata e Faton Mehmetajt për ZPS-në, ku kishte thënë se detyrën si udhëheqës në sektorin e ZKZ-së e ka mbajtur vetëm dy muaj dhe në këtë pozitë pas tij kishte ardhur një person tjetër. Po ashtu, atij i është paraqitur një dokument që thuhej se është lëshuar nga sektori i ZKZ-së, por që dëshmitari ka thënë se nuk e di se kush është autori.

Sipas Dixon, ky dokument përmbante informacione për punën dhe veprimtarinë e



Malokut, gjë për të cilën ky i fundit ka thënë se këtë material e ka parë për herë të parë në Hagë.

Më tutje, Malokut i është paraqitur procesverbali i një mbledhjeje të 30 janarit 1999, ku ishte pjesëmarrës një person me emrin Lulzim Morina, për të cilin dëshmitari ka thënë se nuk i kujtohet nëse ai ishte bërë komandant i Brigadës 135.

Ai ka thënë se emërimi i Morinës në këtë brigadë mund të jetë bërë pas muajit maj të 1999-s.

Dokumenti i radhës që i është shfaqur dëshmitarit, ishte një urdhëresë e 22 marsit 1999, e nënshkruar nga Lulzim Morina si komandant i brigadës në fjalë. Maloku ka thënë se nuk e njeh nënshkrimin e tij por që, sipas tij, dokumenti s'ka asnjë shenjë që është e Zonës Operative të Dukagjinit.

“UÇK-ja ka qenë ushtri vullnetare, roli i inspektorit të përgjithshëm s’ishte përpara dhjetorit të ‘98-s”

Dëshmitari Naim Maloku ka thënë të mërkurën në Hagë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe struktura e saj ka qenë vullnetare. Duke u përgjigjur në pyetjet e avokatit të Rexhep Selimit, Geoffrey Roberts, dëshmitari ka thënë se

roli i inspektorit të përgjithshëm nuk ishte funksional para dhjetorit të vitit 1998.

“Nga ushtari i parë deri tek i fundit, e tërë struktura e UÇK-së ka qenë vullnetare”, ka thënë Maloku.

Maloku është pajtuar që statusin e veteranit e ka marrë edhe dikush që ka mundur ta mbajë uniformën për pak kohë sepse ka qenë në vullnetin e ushtarëve sesa duan të luftojnë dhe kur dëshirojnë që të largohen. “Erdhën dy ushtarë

nga Zvicra, kishin marrë pushim vjetor, njëri një muaj, tjetri një muaj e dy ditë. Kur e kreu pushimin vjetor, e la armën dhe u kthye në Zvicër. Ky tjetri e pati fatin tjetër, edhe dy javë kishte kohë, por u vra dhe sot është dëshmor”, ka thënë Maloku.

Duke folur për Drejtorinë Operative, Maloku ka thënë se ishte ngritur nga Bislim Zyrapi në dhjetor të 1998-s dhe para saj nuk kishte ndonjë strukturë të tillë.

Më pas atij i është paraqitur

dëshmia e 24 marsit 2025, në të cilën Maloku kishte folur për inspektorin e përgjithshëm të UÇK-së. Sipas dëshmitarit, ky rol ka pasur vetëm funksionin e sugjerimit të masave për t’i evituar parregullsitë. Ai ka thënë se raportimi duhej të bëhej te shefi i shtabit. Veç kësaj, Maloku ka thënë se nuk e di se sa ka mundur të jetë funksionale në tërësi kjo strukturë. Ai ka theksuar se pozita e sektorit të inspektorit të përgjithshëm nuk ishte në strukturën e UÇK-së përpara dhjetorit të 1998-s.

Gjithashtu, Maloku ka thënë se nuk kishte drejtori të veçantë për këtë pozitë dhe se Rexhep Selimi ishte epror i respektuar në ushtri, i cili përvojën e kishte fituar në luftë dhe jo akademi siç kanë qenë oficerët e karrierës në UÇK.

Në rolin e tij, dëshmitari Maloku ka thënë se nuk ka pasur asnjë kontakt me Rexhep Selimin në kohën kur është larguar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. “Nuk kam pasur asnjë komunikim dhe as nuk e kam parë”, ka thënë dëshmitari, duke shtuar që vizitat që i bënte nëpër struktura, ia ka komunikuar vetëm komandantit të Zonës Operative të Dukagjinit dhe jo Rexhep Selimit.

Maloku për Thaçin: U emërua drejtor i Drejtorisë Politike në dhjetor të '98-s

Dëshmitari Naim Maloku ka thënë se Hashim Thaçi në dhjetor të 1998-s është emëruar drejtor i Drejtorisë Politike në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.

Dëshmitari ka thënë se ka pasur diskutime në gusht të vitit 1998 lidhur me personin që do t’i përfaqësonte shqiptarët e Kosovës në marrëveshjen me Sllobodan Millosheviqin, raporton “Betimi për Drejtësi”.

Ai ka thënë se Hashim Thaçi gjithmonë ka pasur mirësjellje ndaj Malokut gjatë takimeve. “Nuk kam vërejtur që ka ndonjë mendim jorespektues ndaj meje apo ndonjë qëndrim”, ka thënë Maloku.

Ai është përgjigjur me “e saktë”

kur u pyet se a është e vërtetë që pas mbarimit të luftës (Maloku) është emëruar këshilltar i Hashim Thaçit. “Këshilltar për siguri nga shtatori. Nuk e di datën sa, por në shtator. Kam qenë deri në nënshkrimin e marrëveshjes për demobilizimin e UÇK-së”, ka thënë dëshmitari.

Dëshmitari ka thënë se gjatë luftës, në tetor të vitit 1998, ishte hera e fundit që e kishte parë Thaçin. Ai ka thënë se vetëm në dhjetor të 1998-s ka folur në telefon. “Nuk më kujtohet që e kam pa më fizikisht zotin Thaçi gjatë asaj kohe”, ka thënë Maloku. Ai ka shtuar se nuk ka dijeni nëse Zona Operative e Dukagjinit raportonte në

Shtabin e Përgjithshëm përpara dhjetorit të vitit 1998.

Më tutje, dëshmitari Naim Maloku ka thënë në Hagë se Jakup Krasniqi e ka ushtruar për të paktën dy muaj pozitën e zëvendëskomandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ai ka thënë se këtë pozitë Krasniqi e ka mbajtur në dhjetor të '98-s dhe në janar të '99-s derisa është caktuar anëtar i delegacionit në Rambuje.

Si detyrë parësore, Maloku ka thënë se Krasniqi e kishte atë të zëdhënësit të UÇK-së dhe shef i Drejtorisë për Informim.

“Detyra kryesore bazike ka qenë zëdhënësi i UÇK-së dhe shef i Drejtorisë për Informim”, ka thënë Maloku.

Kurti: Ushtrisë do t’ia ndajmë mbi 1 miliard euro, do të blejmë helikopterë ‘Black Hawk’


Prishtinë, 26 mars - Kryeministri Albin Kurti të mërkurën në mbledhjen e qeverisë ka vënë në pah edhe investimet në fushën e mbrojtjes. Kurti ka bërë më dije se në mandatin e ardhshëm për ushtrinë do të ndajnë mbi një miliard euro. “Në mandatin e ri ushtrisë do t’ia ndajmë mbi 1 miliard euro, do të kemi fabrikë të municioneve dhe dronë ushtarakë ‘Made in Kosova’,

që i prodhojmë vetë. Kemi filluar të blejmë për dallim prej më herët dhe për dallim edhe prej tani do të fillojmë të prodhojmë atë që kemi nisur ta blejmë”, ka thënë Kurti.

Në këtë kontekst, Kurti treguar se Kosova do të blejë nga ShBA-ja edhe helikopterët e famshëm “Black Hawk”. “Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kemi zgjeruar dhe thelluar

marrëdhëniet në fushën e energjisë dhe të mbrojtjes. Grantin më të madh ndonjëherë nga ShBA-ja e ka fituar qeveria jonë në vlerë prej 202 milionë dollarësh për sistemin e baterive të energjisë elektrike. Nga bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes me ShBA-në kemi blerë sistemin raketor anti-tank ‘Javelin’ dhe do t’i blejmë edhe helikopterët ‘Black Hawk’”, ka thënë Kurti.





KENIA, NJË NDËR SHTETET MË TË RËNDËSISHME TË AFRIKËS, NJEH ZYRTARISHT SHTETIN E KOSOVËS

KENIA NJEH PAVARËSINË E KOSOVËS

Kenia ka njohur zyrtarisht shtetin e Kosovës. Lajmin e ka dhënë ish-presidenti dhe ish-kryediplomati Behgjet Pacolli, i cili ka thënë se kjo njohje nuk është thjesht një deklaratë, por fitore e madhe për shtetin e Kosovës. Ai ka thënë se zëri i lirisë së Kosovës do të dëgjohet thellë në zemrën e Afrikës. Pacolli ka vlerësuar se kjo fitore diplomatike nuk ka ndodhur rastësisht, duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës të vendosë menjëherë marrëdhënie diplomatike me shtetin e Kenias. Ndërsa në emër të institucioneve dhe të qytetarëve të Kosovës, presidentja Vjosa Osmani ka shprehur falënderime ndaj presidentit të Kenias, William Ruto, për vendimin për njohjen e shtetit tonë. Po ashtu, Osmani ka falënderuar edhe Pacollin për kontributin për këtë njohje

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

NAIROBI, 26 MARS - Republika e Kosovës të mërkurën ka marrë një lajm fantastik nga ish-presidenti dhe ish-kryediplomati Behgjet Pacolli. Ai ka njoftuar se Kenia ka njohur zyrtarisht shtetin e Kosovës. Pavarësisht se Pacolli nuk ka asnjë funksion publik, ai ka shkuar në shtetin afrikan për ta pranuar njohjen e cila vjen si rezultat i punës së tij disavjeçare. “Nairobi, 26 mars 2025. Sot, Kosova shkruan histori! 17 vjet pas pavarësisë, në një ceremoni të jashtëzakonshme e të paharrueshme, Republika e Kenias, një nga shtetet më të rëndësishme të Afrikës - e njohu

zyrtarisht Republikën e Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran!”, ka shkruar Pacolli në “Facebook”. Pacolli ka thënë se kjo njohje është një fitore e madhe, ku në zemrën e Afrikës do të dëgjohet zëri i lirisë së Kosovës. “Kjo njohje nuk është thjesht një deklaratë – është një fitore e madhe për shtetin e Kosovës, është zëri i lirisë sonë që dëgjohet thellë në zemrën e Afrikës! Sot, flamuri ynë i shtetit ngrihet lart me krenari në Nairobi, dhe kjo është një dëshmi se Kosova ecën përpara, fuqishëm dhe me dinjitet kur punohet dhe ka vullnet për të! Kjo fitore nuk erdhi rastësisht. Ajo është fryt i një pune të gjatë, të palodhur, me përkushtim e sakrificë. Që nga viti 2009, unë

personalisht kam lobuar dhe kam biseduar me autoritetet keniane për ta bërë këtë ditë realitet. Kam shkuar derë më derë, zyrë më zyrë, me vetëm një qëllim – të bëj të njohur zërin dhe të drejtën e popullit të Kosovës për liri, pavarësi dhe sovranitet”, ka shkruar Pacolli, duke shtuar se presidenti i Kenias ia ka mbajtur fjalën e dhënë në vitin 2016. “Presidenti William Ruto, i qëndroi fjalës së dhënë në vitin 2016. Ai e vizitoi Kosovën në vitin 2019 dhe e ndjeu fuqinë dhe vendosmërinë e popullit tonë. Në vitin 2023, gjatë vizitës time në Nairobi, ai e bëri hapin e parë duke njohur pasaportat tona. Sot, në një ceremoni madhështore, ai e tha me zë të lartë: Kosova është shtet i njohur nga Kenia!”, ka

shkruar Pacolli.

Më tutje, Pacolli i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës, e cila nuk ka asnjë meritë për këtë njohje, që të vendosë menjëherë marrëdhënie diplomatike me Kenian.

“Kjo është diplomaci me rezultat. Kjo është Kosova që e respektojnë! Kjo është fitorja e dinjitetit tonë kombëtar në arenën ndërkombëtare! I bëj thirrje qeverisë së Kosovës që menjëherë të vendosë marrëdhënie diplomatike me Kenian dhe të hapë një Ambasadë të përbashkët me Republikën e Shqipërisë në Nairobi. Kosova duhet të jetë prezente aty ku respektohet dhe mbështetet – në zemrën e Afrikës! Kjo ambasadë do të jetë porta e Kosovës për të hyrë fuqishëm në kontinentin afrikan, për të ndërtuar aleanca të reja politike, ekonomike dhe kulturore”, ka shkruar Pacolli, i cili i ka falënderuar tre persona për kontributin që kanë dhënë në këtë proces.

“Dua të shpreh falënderimin për bashkëpunëtorin tim të ngushtë, Jetlir Zyberaj, i cili ka qenë në mënyrë permanente syri dhe veshi im jo vetëm në këtë proces të rëndësishëm për Kosovën. Një falënderim të veçantë dua t’i shpreh edhe Shqipërisë, presidentit Begaj dhe kryeministrit Edi Rama të

cilët më kanë dhënë mbështetje shtetërore. Kjo është dita kur Kosova u pa, u dëgjua dhe u pranua. Kjo është dita kur populli ynë duhet të ndiejë krenarinë e një fitoreje që nuk ka çmim – njohjen ndërkombëtare të shtetit tonë. Faleminderit Kenia! Faleminderit President Ruto! Lavdi Kosovës dhe qytetarëve të saj krenarë!”, ka shkruar Pacolli. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, Kenia ka mbi 55 milionë banorë dhe është një nga shtetet më me ndikim në Afrikë. Njohja e fundit që kishte marrë Kosova është ajo nga Izraeli para pesë vitesh.

Osmani mirëpret njohjen nga Kenia: Vendimi i nënshkruar nga Ruto ka ardhur në Presidencë. Falënderim i veçantë për ish-presidentin Pacolli

Presidentja Vjosa Osmani ka konfirmuar se vendimi i Kenias për njohjen e pavarësisë së Kosovës është dërguar zyrtarisht pak më parë në Presidencë, i nënshkruar nga presidenti i Kenias, William Ruto. “Kjo njohje është një dëshmi e mbështetjes së vazhdueshme për të drejtën e popullit të Kosovës për liri, pavarësi,

Supremja rrëzon ankesën e LV-së për rezultatin e zgjedhjeve, hapet rruga për certifikimin e tyre

Prishtinë, 26 mars - Gjykata Supreme e Kosovës, instanca më e lartë e gjyqësorit, ka refuzuar ankesën e Vetëvendosjes ndaj PZAP-së për rezultatet përfundimtare të shpallura

nga KQZ-ja. Supremja ka mbështetur tërësisht vendimin e PZAP-it. “Nga gjendja si më lartë me pretendimet ankimore, me asnjë provë nuk ka vihet në dyshim gjendja faktike e

vërtetuar si më lartë nga ana e organit, vendimi i të cilit është kontestuar, andaj si të pabazuara vlerësohen pretendimet e ankuesit në ankesë, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo

të plotë të gjendjes faktike. Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të

këtij aktgjykimi”, është thënë në vendimin e Supremes. Refuzimi i kësaj ankese dhe disa të tjerave i ka hapur rrugë certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja.

KATËR VRASJET NË TRI DITËT E FUNDIT, KRASNIQI: SHTETI TË ZGJOHET URGJENTISHT, KONTROLL I RREPTË I ARMËVE

PRISHTINË, 26 MARS - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka reaguar në lidhje me katër vrasjet në tri ditët e fundit në Kosovë. Krasniqi ka thënë se ndalimi i këtyre akteve është emergjencë kombëtare. “Brenda vetëm tri ditësh, katër jetë u shuan nga armët e zjarrit në Kosovë. Një grua, një i ri dhe dy burra – secili me një histori, me ëndrra, me familje që tani janë zhytur në dhembje të pamatshme. Këto nuk janë thjesht statistika. Këto janë jetë të vjedhura, familje të shkatërruara dhe një shoqëri që vazhdon të dëshmojë tragjedi pa asnjë veprim shtetëror të vendosur. Sa jetë të tjera duhet të humbasim që të pranojmë se kjo është një emergjencë kombëtare? Sa familje të tjera duhet të shkatërrohen që të kuptojmë se qasja e lehtë në armë dhe dështimi i shtetit për të vepruar me vendosmëri janë një kombinim vdekjeprurës?”, ka shkruar Krasniqi në rrjetet sociale. Krasniqi ka thënë se kjo pasiguri dhe ankth për qytetarët nuk

duhet të normalizohet. “Pasiguria ka kapluar vendin tonë. Një ndjenjë frike dhe pasigurie ka zënë rrënjë në shoqëri, duke e bërë jetën e qytetarëve të rënduar nga ankthi dhe droja për të nesërmen. Askush nuk duhet të jetojë me frikën se një armë e jashtëligjshme mund t'i marrë jetën në çdo moment, në rrugë, në shtëpi apo në vendin e punës”, ka shkruar Krasniqi. Ai ka kërkuar nga institucionet e Kosovës të veprojnë me urgjencë në raport edhe me kontrollimin e armëve. “Nuk mund ta normalizojmë këtë gjendje – nuk guxojmë. Nuk mund të heshtim. Shteti duhet të zgjohet. Institucionet duhet të veprojnë me urgjencë. Kontroll më i rreptë i armëve, forcim i rendit dhe drejtësi e pakompromis – këto nuk janë thjesht politika, por çështje jete dhe vdekjeje. Partia Demokratike e Kosovës, në legjislaturën e re, pas konsolidimit të institucioneve dhe qeverisë së re, do ta iniciojë ndryshimin e Kodit Penal dhe legjislacionit përkatës për t'i



ashpërsuar dënimet për armëmbajtjen pa leje. Kushdo që ka apo përdor armë ilegalisht, duhet të përballet me burg, pa përjashtim. Kosova nuk mund të jetë një vend ku jeta njerëzore humbet vlerën. Është koha të kthjellemi. Është koha ta zgjedhim jetën. Ngushëllimet më të thella familjeve të viktimave!”, ka shkruar Krasniqi. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka ftuar organet e rendit dhe të drejtësisë t'i trajtojnë me seriozitet shkaqet, rrethanat dhe “predispozitat e dorasëve”, në mënyrë që të vihet drejtësi për vrasjet e ndodhura

ditët e fundit në Kosovë dhe të parandalohen raste të tilla. “Natyrisht, na duhet një analizë e kujdesshme profesionale, veprim i menjëhershëm institucional, reflektim shoqëror që adreson dhunën që kemi parë në ditët e fundit”, deklaroi Kurti, duke kërkuar angazhim maksimal nga organet e rendit dhe drejtësisë. Më 23 mars një 19-vjeçar është vrarë në Vushtrri nga një bashkëmoshatar i tij. Po në Vushtrri, një ditë më vonë një burrë ka vrarë një grua 42-vjeçare. Dorasi, 58 vjeç, më pas ka vrarë veten. Ndërsa

mbrëmjen e 25 marsit, një burrë është vrarë në Prishtinë, ndërsa një tjetër ka mbetur i plagosur pasi, sipas policisë, ata janë sulmuar nga dy persona të maskuar dhe të armatosur. Sipas të dhënave nga Policia e Kosovës, vitin e kaluar në Kosovë janë regjistruar 17 vrasje, ndërsa më 2023 janë regjistruar 29 të tilla. Ekspertët e fushës së sigurisë kanë thënë se numri i vrasjeve tregon se çështja e armëmbajtjes është bërë alarmante, duke kërkuar të kenë një qasje më gjithëpërfshirëse, përfshirë këtu edhe ndërgjegjësimin e të rinjve për pasojat e armëve. Në Kosovë ka ligj për pajisjen me leje për armë, që përcakton se kush dhe nën çfarë kushtesh mund të pajiset me armë zjarri. Ligjet, po ashtu, parashohin dënime me gjoa dhe me burgim për poseduesit e armëve pa leje. Në vend llogaritet se janë mbi 230 mijë armë pa leje në duart e qytetarëve. Policia ka treguar se çdo vit konfiskon mesatarisht rreth 1 500 armë pa leje.

Prokuroria nis hetimet për votimin me postë

Prishtinë, 26 mars - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka nisur hetimet lidhur me procesin e votimit me postë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Njoftimi për nisjen e hetimeve vjen pasi partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje (LV), ka pretenduar se ka pasur manipulime në votimet me postë të orkestruara nga subjekti opozitar, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). “Prokuroria Themelore në Prishtinë e ka autorizuar Policinë e Kosovës për grumbullimin dhe verifikimin e informacioneve, mirëpo në këtë fazë të procedurës nuk mund të jepen më shumë

hollësi sepse mund të cenohet procesi hetimor”, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë”, Kaltrina Shala nga Zyra për Komunikim në Prokurorinë Themelore të Prishtinës. Lëvizja Vetëvendosje kishte kërkuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa anulimin e afër 19 000 votave me postë të LDK-së dhe përsëritjen e votimit për shkak të pretendimeve për manipulim zgjedhor. Por, PZAP-i ia ka hedhur poshtë kërkesën. Zyrtarë të Lëvizjes Vetëvendosje kishin thënë më herët se ia kanë dërguar edhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë provat që thoshin se



mbështesin pretendimet e tyre për manipulime zgjedhore. Kjo parti ka argumentuar se disa kandidatë të LDK-së kishin marrë shumë më shumë vota me postë sesa në votimin brenda Kosovës. Po ashtu, LV-ja ka thënë se votimi me postë ka ndodhur “në formë të manipuluar, të organizuar

masivisht dhe kolektivisht nga persona të njëjtë me stilolaps të njëjtë, me ngjyrë të njëjtë dhe me duar të njëjta”. LDK-ja ka hedhur poshtë akuzat e LV-së duke thënë se ato po bëhen “vetëm pse nuk u pëlqen rezultati”. Kjo parti, në anën tjetër, e ka akuzuar LV-në për manipulim të votave në përfaqësi diplomatike, por edhe me postë. Kosova po pret që të përmbillet afati i shqyrtimit të ankesave të partive dhe subjekteve politike drejtuar Gjykatës Supreme, në mënyrë që të certifikohet rezultati zgjedhor dhe t'i hapet rruga formimit të institucioneve të

reja. Sipas rezultatit përfundimtar, të shpallur më 15 mars, Lëvizja Vetëvendosje ka dalë e para me mbi 390 000 vota apo 42.30 për qind. E dyta është Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me mbi 190 000 vota, apo 20.95 për qind, pasuar nga LDK-ja me mbi 170 000 mijë vota, apo 18.27 për qind. Në vendin e katërt është koalicioni në mes të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Social-Demokrate me mbi 66 000 vota apo 7.06 për qind. Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - ka siguruar mbi 39 000 vota apo 4.26 për qind.

soveranitet dhe integritet territorial. Njëkohësisht është edhe njohje e vuajtjeve të gjata e sakrificës shekullore të popullit të Kosovës për liri”, ka thënë Osmani. Në emër të institucioneve dhe të qytetarëve të Kosovës, Osmani ka shprehur falënderime ndaj presidentit të Kenias, William

Ruto, për “këtë vendim të drejtë dhe të rëndësishëm, si dhe ndaj institucioneve dhe qytetarëve kenianë që mbështetën këtë hap të madh diplomatik”. Osmani ka thënë se “përgjatë këtyre viteve kam zhvilluar disa takime të rëndësishme me të, në të cilat njohja e Kosovës ka qenë temë kryesore e diskutimeve”.

“Presidenti Ruto vazhdimisht siguronte popullin e Kosovës se vendimi për njohje do të merret shpejt, bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe në sakrificën e gjatë të popullit tonë”, ka thënë Osmani. Presidentja e ka falënderuar edhe ish-presidentin Behgjet Pacolli për kontributin e tij në

këtë njohje. “Një mirënjohje e veçantë shkon për të gjithë ata që kontribuan në këtë proces. Falënderim të veçantë për angazhimin e vazhdueshëm të ish-presidentit dhe ish-ministrit të punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli. Kosova vazhdon të ecë përpara në rrugën e saj të integritetit dhe fuqizimit të

pozitës së saj ndërkombëtare. Marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Kenias do të thellohen në fusha të ndryshme, ndaj presim që shumë shpejt të vendosim marrëdhënie diplomatike, duke ndërtuar një partneritet të fortë dhe afatgjatë në mes dy shteteve dhe popujve tanë”, ka thënë Osmani.

MASAKRA E KRUSHËS SË MADHE, DËSHMI E MIZORISË SË REGJIMIT GJENOCIDAL TË MILLOSHEVIQIT

Presidentja Vjosa Osmani është zotuar se nuk do të ndalen asnjëherë derisa drejtësia të triumfojë mbi krimet mizore të Serbisë. Këtë zotim ajo e ka dhënë në Krushë të Madhe me rastin e 26-vjetorit të masakrës në këtë fashat. “Ne nuk duhet të heshtim, nuk duhet të ndalemi, nuk duhet të lejojmë që drejtësia të vonohet pafundësisht, sepse drejtësia për Krushën e Madhe është drejtësi për të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë tonë, për heronjtë e UÇK-së dhe për martirët e lirisë”, ka thënë Osmani

EPOKA E RE**Lirim GECI**

RAHOVEC, 26 MARS - Të mërkurën janë përkujtuar të rënë në masakrën e tmerrshme në Krushë të Madhe dhe asaj të Vogël. Në tubimin përkujtimor të mbajtur në Krushë të Madhe të Rahovecit kanë marrë pjesë përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale, familjarë dhe qytetarë të shumtë.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, para familjarëve të të masakruarve 26 vjet më parë në Krushë të Madhe, është betuar se nuk do të ndalen asnjëherë derisa drejtësia të triumfojë e krimet mizore të Serbisë ta marrin dënimin e merituar.

E para e vendit ka thënë se kur në një fshat vriten kaq shumë njerëz të pafajshëm e derdhet kaq shumë gjak, ai nuk është vetëm një vend në hartë, por është një dëshmi e përjetshme. “Sot qëndrojmë në Krushë të Madhe aty ku dhembja është gdhendur në çdo gur, në çdo prag shtëpie, në çdo zemër që rreh për drejtësi. Para 26 vitesh ky fshat u goditë nga një prej krimeve më të tmerrshme të regjimit gjenocidal të Serbisë. 241 burra e djem u masakruan, mes tyre 7 fëmijë e 5 gra përfshirë edhe një grua

shtatzënë”, ka thënë Osmani.

Edhe pas 26 vitesh, kur ende 64 persona figurojnë të zhdukur, e para e shtetit ka thënë se është një krim i shumëfishtë i Serbisë gjenocidale sepse familjet e tyre jetojnë çdo ditë me dhimbjen, me mallin e një pritjeje që nuk merr fund asnjëherë. “E në këtë radhë të gjatë të dhimbjes qëndron edhe një emër i madh i kombit tonë, një mendjendritur, një figurë e paharruar, Ukshin Hoti. Prej më shumë se dy dekadash edhe fati i tij, sikurse i të gjithë banorëve të Krushës që sot janë të zhdukur me dhunë, mbetet i pazbardhur”, ka thënë Osmani para familjarëve në këtë ditë përkujtuese.

E para e shtetit ka thënë se një intelektual, një patriot, një zë i guximshëm i kombit u mor me dhunë nga regjimi kriminal serb, ndaj prej atëherë nuk dihet më asgjë për të, përveçse atë e mori Serbia. “Ky mister nuk është vetëm një padrejtësi ndaj Ukshin Hotit e familjes së tij, por një plagë në ndërgjegjen e njerëzimit. Sepse pyetja, ‘ku është Ukshin Hoti?’, ende kërkon përgjigje, siç kërkojnë përgjigje edhe rreth 1 600 të zhdukur me dhunë”, ka thënë Osmani, duke shtuar se



masakra e Krushës së Madhe nuk është vetëm një krim i tmerrshëm i para 26 vitesh, por është e përditshmja, është e sotshmja. “Sepse dhimbja vazhdon edhe sot, njësor si para 26 vitesh. Ajo është një betejë e hapur për drejtësi, prandaj nuk mund të lejojmë që gjaku i atyre të mbetet pa zë, e sakrifica e tyre të harrohet. Ne nuk duhet të heshtim, nuk duhet të ndalemi, nuk duhet të lejojmë që drejtësia të vonohet pafundësisht, sepse drejtësia për Krushën e Madhe është drejtësi për të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë tonë, për heronjtë e UÇK-së dhe për martirët e lirisë. Sot para kujtimit të martirëve tanë, para dhembjes së familjeve të tyre, para kësaj toke të shenjtë, ne bëjmë betim. Nuk do të ndalemi asnjëherë derisa drejtësia të triumfojë. Nuk do të pushojmë derisa krimet që u kryen nga Serbia ta marrin përgjigjen e duhur. Nuk do ta harrojmë kurrë sakrificën e Krushës së Madhe”, ka thënë Osmani.

Ndërsa kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, është shprehur se Krusha e Madhe, e cila mban emrin dhe dhembjen e madhe, është dëshmi e krimeve të Serbisë gjenocidale. “Bashkë me familjarë, të mbijetuar e dëshmitarë të masakrës së Krushës së Madhe, përkujtojmë sot një nga masakrat më mizore të kryera nga aparati shtetëror serb. Ndërmjet 25 dhe 27 mars 1999, forcat serbe këtu vranë pamëshirshëm 155 civilë shqiptarë. Në mesin e tyre ishin edhe shtatë fëmijë e pesë gra. Njëra nga to ishte shtatzënë. Forcat e Serbisë zhdukën me dhunë 64 krushjanë, mes tyre edhe intelektualin e jashtëzakonshëm e veprimtarin e paepur Ukshin Hoti. Mbi 700 shtëpi u dogjën, bashkë me institucione fetare dhe kulturore”, ka thënë Kurti. Ai ka përmendur edhe dy krematoriumet e Krushës së Madhe. Në krematoriumin e parë, gjurmët e të cilit janë ende të dukshme, forcat serbe kanë djegur 19 civilë të pafajshëm shqiptarë. Ndërsa në krematoriumin e dytë, në shtëpinë e familjes së Nezir Durakut janë djegur mizorisht mbi 40 civilë të tjerë.

Për këto dy krematoriume të cilat i kishte parë personalisht ministri i Jashtëm i Britanisë së Madhe, Robin Cook, gjatë vizitës së tij në qershor të vitit 1999, ai kishte thënë: “Ata i kishin vranë qëllimisht dhe pamëshirshëm”, dhe se “po aq sa ndien keqardhje për viktimat, ndien zemërim të thellë ndaj atyre që kryen këto vrasje dhe ndaj atyre që dhanë urdhrat në Beograd”.

Masakra në Krushë të Madhe ishte pjesë e aktakuzës për krime lufte kundër kasapit të Ballkanit, Slllobodan Millosheviq. Përkundër kësaj, drejtësia ende nuk ka vepruar dhe kryerësit nuk janë dënuar. Kryeministri ka theksuar se është evidente që policët dhe ushtarët e Serbisë kanë pasur

urrejtje të madhe dhe plan të qartë për t'i kryer krimet, ku brenga e tyre më e madhe ka qenë zhdukja e kufomave, pra zhdukja e gjurmëve të krimit. “Zhdukjet me dhunë, rrëmbimet, djegiet dhe hedhja e kufomave në lumë, e forma të tjera çnjerëzore të dëmtimit e zhdukjes së kufomave, janë dëshmi të qarta të këtij projekti gjenocidal”, ka thënë ai.

Haradinaj: Krimet e tmerrshme, dëshmi e gjenocidit serb në Kosovë

Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar dhe nderuar të rënë në masakrat e marsit 1999 në Krushë të Madhe, Krushë të Vogël dhe Suharekë, duke theksuar se këto krime të tmerrshme janë dëshmi e gjenocidit serb në Kosovë. “Ato ditë marsi regjimi gjenocidal kreu një nga krimet më monstruoze dhe të planifikuara, duke ekzekutuar pa mëshirë 350 gra, pleq, fëmijë dhe të rinj të pafajshëm”, ka shkruar Haradinaj në rrjetet sociale, duke shtuar se ndan dhimbjen me familjarët që humbën më të dashurit e tyre. Ai ka kujtuar me dhimbje dhe nderim edhe 49 martirët e familjes Berisha nga Suhareka, të cilët u ekzekutuan mizorisht nga forcat serbe, si dhe 23 viktimat nga Landovica e Prizrenit dhe fshatrat përreth. “Fëmijë e të moshuar u ekzekutuan pamëshirshëm, vetëm pse ishin shqiptarë, në tokën dhe në të drejtën e tyre. Masakrat anëmbanë Kosovës janë dëshmi e sakrificës së popullit tonë për liri. Ne nuk harrojmë dhe nuk do të ndalemi kurrë së kërkuari drejtësi për këto krime!”, është shprehur Haradinaj.



ALBIN ZHDANOVI!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

1. Andrej Zhdanov: Ishte njëri ndër udhëheqësit e Partisë Komuniste Sovjetike dhe konsiderohej si pasardhës i Stalinit, por se vdiq para Stalinit. Ai konsiderohej si kryepropaganduesi në Bashkimin Sovjetik në periudhën 1945 - 1948 dhe ideolog kulturor. Realisht ishte ideolog i terrorit ndaj kundërshtarëve politikë. Qasja e Zhdanovit njihet si doktrinë zhdanoviste që nënkupton ta bëjë partinë një mjet për edukim politik, agjitacionin në baza ideologjike dhe manipulimin mbi këto baza të masave të gjëra. Ishte ideolog i Terrorit të Madh dhe hartues i listave për ekzekutim të kundërshtarëve politikë. Bëri pastrim në baza ideologjike duke diferencuar shumë shkrimtarë të njohur si Ana Ahmatova dhe kompozitorë me renome ndërkombëtare si: Dmitri Shostakovich, Sergei Prokofiev, Aram Khachaturian, etj. Në takimin e Cominform në Bukuresht në vitin 1948 për shkak të qëndrimit të butë ndaj Jugosllavisë, Stalini e zëvendësoi menjëherë me Malenkovin dhe e dërgoi në një sanatorium. Aty iku përlesh. Kur flitet për doktrinën zhdanoviste nënkuptohet lufta kundër çdo gjëje përparimtare që del jashtë kriterëve të edukimit politik dhe guacës ideologjike e që janë të

përcaktuara nga partia komuniste që dhunën e ka mjet për të ardhur në pushtet kurse terrorin dhe trushpërlarjen përdorë për të qëndruar në pushtet. Këtu viktimat nuk konsiderohen qenie njerëzore, por vetëm numra për statistikë. Edhe sot Zhdanovi përmendet si mishërim i personit që propagandën e ka pasqyrë për deformim të realitetit, shpërlarje të trurit, likuidim politik dhe fizik i kundërshtarëve politikë dhe ideologjikë apo armiqve të popullit dhe marrjes së dhe mbajtjes së pushtetit mbi themele të propagandës dhe manipulimit ideologjik. Ky ishte Andrei Zhdanov i Partisë Komuniste Sovjetike po kush është riinkarnimi i tij në Kosovë?! Besoj se e keni të qartë përgjigjen.

2. Albin Kurti apo Zhdanovi i Kosovës: Profili politik është i deklaruar si i majtë, neoliberal i ngatërruar me një nacionalizëm të imagjinuar. I angazhuar për drejtësi sociale, një Fidel Kastro, Horhe Mojica, Hugo Chavez, Nicolas Maduro apo Slavoje Žižek, por se jetën e bënë si një aristokrat tradicional, jo se ka pasuri personale, por se e ka personalizuar shtetin përmes pushtetit. Stoik i dikurshëm si Zenoni apo Epikteti, diktator i tashëm si Cezari dhe Neroni. Për rrethana tona orator si Ciceroni kurse dyfytirësh si

Mark Antoni. Ambalazhimin e urtësisë e ka si Kato kurse shpërthimin e urrejtjes ndaj hajvanëve e ka si Fulvia apo Sulla. Është kryepropagandist sikur Zhdanovi dhe këtë e përdori për të ardhur në pushtet, vazhdon ta përdorë për të mbetur në pushtet, me çdo kusht dhe me të gjitha mjetet. Ka dëshirë t'i drejtohet urbi et orbi masave të gjëra për t'i njoftuar për rreziqet nga armiq të jashtëm e më shumë nga armiq të brendshëm (opozita) edhe në gjuhën shqipe e sidomos në gjuhën serbe kur fletë laudato për kriminelin Oliver Ivanoviq dhe antishqiptarin Zoran Gjingjiq. Bashkimin kombëtar do ta bëjë me Alim Ramën, Nenad Rashiqin, Elbert Krasniqin, Emily "Bronte" Rexhepi dhe Eden Atiq që kanë një të kaluar të pastër "kombëtare" dhe angazhim për bashkim kombëtar. Këta që ishin kundër bashkimit kombëtar i dërgoi në Burgun e Hagës. I mençur është Cezari shqipfolës. Mendon se është i mençur. Bashkë me Zonjën e Mallkuar të LV-së, Dejana Mihalini, atë këshilltarin Ho Shi Min nga Azia dhe alfa dhe omega e mendimit politik, ideologjik dhe intelektual, z. Agim Bahtiri dhe Halil Thaçi nxori një videomesazh për mandatin dhunues 4-vjeçar të qeverisë Kurthi 2, e që po të mos shihej autori (dhunuesi),

do të mendoni se vjen nga Norvegjia, Finlanda, Suedia apo Islanda e jo nga një vend të cilin e ka "lëpirë thiu", si vendi më i varfër në Evropë apo Evropë, i izoluar në skamje, me sanksione, me pak miq dhe me shumë armiq, ku të rinjtë plaken para kohe kurse pleqtë banojnë afër kontejnerëve duke e zgjedhur vdekjen para pensionit, ku rrugaçët dhe kriminelët ta lëshojnë dhe ndalin rrymën duke e rritur mbi 140 për qind brenda mandatit dhunues katërvjeçar. Se rrejnë dhe mashtrojnë Besnik Rrenc Bislimi, Donika Shvarc Zeza apo Hajnrollah Çeko, nuk isha befasuar aspak, është situatë normale! E se që në majo të kësaj piramide mashtroese qëndron me "nder dhe dinjitet" Albin Kurti, as nuk e kisha besuar, as nuk e kisha dëshiruar. Kjo është e vërteta absolute, për fat të keq. Prandaj Albini nuk mund të ketë as përfundim të mirë e së paku të lavdishëm të karrierës politike. Sikur të gjithë diktatorët. Sikur Cezari, sikur Zhdanovi. Ka mundur të bëjë gjëra të mira, kemi besuar se do të bëjë gjëra të mira. U dridh mali, polli miu, kjo është puna dhe rezultati i Albinit. Na ofroi një videomesazh me përmbajtje sadiste, sikur të ishim pacientë e jo qytetarë të Republikës, si po e quajnë. Sikur të ishim kursantë në kursin kundër

analfabetizmit. Këtë mund ta bëjnë vetëm njerëzit e ligj, pa ndjenja elementare të empatisë, të zhveshur nga çdo skrupull moral. Duhet të jesh së paku sadomasokist ta bësh atë videomesazh, duhet të jesh së paku sadist ta shpërndash sikur edhe të jesh leshko t'i besosh këtij prostitucioni propaga-ndistik. Fatkeqësisht!

3. Ngjarjet që e shënuan muajin: Pa asnjë dyshim ishte solidariteti i madh me presidentin Hashim Thaçi për humbjen e babait, Haxhi Thaçi. Ishte edhe një revoltë kundër Gjykatës Speciale Raciste. Shqiptarët e VVLEN -it në Maqedoni të Veriut po transformohen; nga një element konstituiv, në një element marginal falë Albinit, Travarit dhe Bekim Koçes. Në Luginë janë heshtur në vdekje mortore politike "troçtarët e Albinit", as pordhët nuk po u dëgjohen. Në Mal të Zi askush nuk fletë për shqiptarë përveç Millo Gjukanoviqit që është 100 herë më shqiptar se Abazoviqi. Në Shqipëri kemi prekur fundin e mjerimit njerëzor, kombëtar, politik dhe moral, Sali Berisha dhe Ilir Meta kanë bërë koalicion për një "Shqipëri Madhështore...". Cili njeri normal e beson këtë ?!, kur as Saliu e Likja nuk e besojnë.

Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e Ditës së Çlirimit

PRISHTINË, 26 MARS - Qeveria e Kosovës ka themeluar të mërkurën Këshillin Organizativ për shënimin e 12 qershorit -

Ditës së Çlirimit të Kosovës. Ky Këshill do të kryesohet nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

Hajrulla Çeku, ndërsa anëtarë do të jenë ministri i Mbrojtjes, ai i Punëve të Brendshme, ministri i Pushtetit Lokal, ministrja

e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ministrja e Drejtësisë dhe një përfaqësues nga zyra e kryeministrit.



ATK-ja: “Freelancer”, “influencer” dhe “out-source”, t’i deklarojnë dhe paguajnë tatimet

PRISHTINË, 26 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka kërkuar nga qytetarët të cilët ofrojnë shërbime si “freelancer”, “influencer”, “out-source”, se janë të detyruar t’i deklarojnë dhe t’i paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Në njoftimin e lëshuar për

medie është thënë se aktivitetet e ATK-së në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te personat të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e realizuara dhe nuk paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale. “Të gjithë personat të cilët krijojnë të ardhura në Kosovë dhe jashtë Kosovës nga aktiviteti i tyre si ‘freelancer’, ‘influencer’ ‘out-source’ etj.,

janë të obliguar t’i deklarojnë dhe paguajnë tatimet sipas rregullave mbi objektin e tatimit bazuar në legjislacionin tatimor të Kosovës në fuqi. Kur shërbimi si ‘freelancer’, ‘influencer’ ‘out-source’ etj., ofrohet si i punësuar, të ardhurat nga paga i nënshtrohen tatimit të mbajtur në burim nga punëdhënësi vendor, ndërsa nëse i

punësuar gjendet në Kosovë dhe punëdhënësi jashtë Kosovës, atëherë personi përfitues obligohet që individualisht ta bëjë pagesën e tatimit dhe kontributit pensional”, ka njoftuar ATK-ja. Me këtë rast, ATK-ja i ka inkurajuar të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t’u përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të



kundërtën “ATK-ja do të detyrohet t’i ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor”.

I dyshuari për rastin e rezervave shtetërore, Irfan Lipovica, emërohet drejtor i Akreditimit në MINT

PRISHTINË, 26 MARS - Irfan Lipovica, i cili ishte arrestuar nën dyshimin për përfshirje në rastin e njohur si rezervat shtetërore, është emëruar nga qeveria Kurti, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Akreditimit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Lipovica ishte arrestuar nën dyshimin për rastin e njohur “rezervat shtetërore”. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, në shpjegimin e propozimit ka thënë se ky institucion ka rëndësi të lartë për ekonominë. “Akreditimi si një proces me rëndësi të lartë për ekonominë vërteton cilësinë dhe besueshmërinë e institucioneve dhe bizneseve, pasi përmes këtij procesi vlerësohet përputhshmëria e produkteve dhe proceseve e shërbimeve me standarde ndërkombëtare dhe vendore, duke garantuar që ato të ofrojnë një nivel të lartë të

cilësisë”, ka thënë ajo. Lipovica ishte arrestuar si zyrtar i MINT-it në mes të gushtit 2023, pas një aksioni të Prokurorisë Speciale në këtë ministri. Përveç tij, ishin arrestuar edhe Hafiz Gara dhe biznesmeni Ridvan Muharremi. Ata janë liruar nga paraburgimi në fund të gushtit. Muharremi dyshohej se kishte ndihmuar dy zyrtarët shtetërorë, Lipovicën dhe Garën, ta shkelin ligjin gjatë procesit të blerjes së rezervave shtetërore. Sipas Prokurorisë, shteti pësoi një dëm rreth 600 mijë euro në këtë proces. Ministria Rozeta Hajdari deklaroi se zyrtarët e MINT-it janë të pafajshëm dhe nuk kanë kryer shkelje ligjore. Në lidhje me çështjen e rezervave shtetërore, për një intervistë është ftuar edhe kryeministri Albin Kurti, i cili ka kërkuar që prokurorët ta intervistojnë në zyrën e tij. Aktualisht, Lipovica ka disa muaj që ushtron detyrën e ushtruesit të detyrës



së drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës. Drejtorja e Akreditimit të Kosovës (DAK) është Organ Kombëtar i Akreditimit në

Kosovë që vlerëson, në përputhje me standardet ndërkombëtare, kompetencën teknike të organeve të vlerësimit të konformitetit, të

cilët kryejnë aktivitete të tillë si: testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim qofshin në sektorët publikë apo privatë të fushës vullnetare apo të detyrueshme.

Rritje të pagës minimale mbi 500 euro dhe 100 milionë euro për barnat esenciale, qeveria shpalos planet për të ardhmen

PRISHTINË, 26 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të mërkurën në mbledhjen e qeverisë ka thënë se për katër vjet “kanë arritur rezultate të jashtëzakonshme”. Kurti ka përmendur rritjen e pensioneve dhe shtesat për nënat lehona dhe fëmijët. Ai ka përmendur edhe rritjen e pagave në sektorin publik dhe rritjen e pagës minimale në sektorin privat, për të cilën tha se në mandatin e ardhshëm do të rritet mbi 500 euro. “Kemi rritje të pensioneve. Për mbi 300 mijë pensionmarrës janë rritur 20 për qind, përveç rritjes së rregullt, të gjithë kanë marrë shtesa prej 100



eurosh pesë herë gjatë mandatit tonë. Rreth 70 mijë nëna lehona sërish për herë të parë kanë marrë shtesa nga shteti, sikurse edhe mbi 400 mijë fëmijë. Për fëmijët i kemi dyfishuar dhe trefishuar shtesat. Tri herë kemi rritur pagën në sektorin publik, në sektorin privat pagën minimale dy herë. Nga 130-170 sa e kemi gjet në 265 euro dhe nga 265 në 350 euro. Mandatin tjetër do ta rrisim përsëri mbi 500 euro”, ka thënë Kurti. Kurti ka përmendur edhe sektorin e shëndetësisë, ku ka premtuar se në mandatin e ardhshëm do ta rrisin buxhetin për listën esenciale të barnave

deri në 100 milionë euro. “Shëndetësia publike është bërë më e mirë, më e lirë dhe me shumë shërbime kemi. Shumicën prej klinikave i kemi transformuar, shumë prej shërbimeve jetike për qytetarët janë bërë pa pagesë e disa me çmime më të përballueshme. Mandatin që na pret do të vazhdojmë me investime spital pas spitali. Do të ndërtojmë dy spitale të reja e gjashtë poliklinika specialistike. Buxhetin për listën e barnave esenciale, që tashmë është në nivel rekord, do ta ngrehim deri në 100 milionë euro”, është shprehur Kurti.

Më 1 prill mbahet ankandi i katërt i letrave me vlerë

Prishtinë, 26 mars - Më 1 prill do të mbahet ankandi i katërt për vitin 2025. Në këtë ankand do të emetohen obligacione

me maturitet shtatëvjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh. “Investimi në obligacione është investim i

sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu

ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (7 vite) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi”, ka njoftuar Ministria e Financave.



TRUMP: KA TË DREJTË VANCE, EVROPIANËT JANË PARAZITË




Tani Europa e di çfarë mendon privatisht administrata Trump. Evropianët kanë reaguar me zemërim dhe habi ndaj publikimit të pjesëve të një bisede në chat, ku përfaqësues të qeverisë amerikane, përfshirë nënpresidentin J. D. Vance dhe sekretarin e Mbrojtjes Pete Hegseth, shprehnin “urrejtje” dhe “neveri” ndaj Evropës. Dje, për të mbrojtur zëvendëspresidentin dhe kreun e Pentagonit, Donald Trump e forcoi akoma më shumë pozicionin, duke deklaruar publikisht: “Mendoj se evropianët janë parazitë”. Por edhe në Shtetet e Bashkuara rasti ka shkaktuar siklet. Deputeti republikan nga Nebraska, Don Bacon, e ka

kritikuar hapur chat-in: “Mënyra se si urrejnë Evropën është e turpshme”. Shumë konservatorë ndihen prej kohësh në siklet për shkak të sulmeve që administrata Trump lëshon ndaj aleatëve historikë. Vance përshkruhet si “më anti-evropian” se vetë Trump. Ai kishte sulmuar tashmë aleatët në konferencën e Mynihut, kur kishte përmendur një “vetëvrasje të qytetërimit”. Por tronditëse ishin fjalët në chat-in privat në platformën Signal, të cilat dolën në dritë sepse gabimisht, ishte futur në bisedë edhe drejtori i revistës The Atlantic, Jeffrey Goldberg, i cili publikoi disa pasazhe. Një nga çështjet ishte vendimi për të sulmuar Houthi-t në

Jemen, për të siguruar rrugët tregtare. “E urrej thjesht që po më duhet të shpëtoj përsëri Evropën”, kishte shkruar Vance. “E ndaj neverinë tënde për Evropën, që përfiton pa paguar – është patetike”, i ishte përgjigjur Hegseth. “Por Mike ka të drejtë, jemi të vetmit në botë që mund ta bëjmë këtë. Është vetëm problemi i kohës”. Në të vërtetë, më shumë se njëzet vende janë të përfshira në mbrojtjen e anijeve tregtare në ato rrugë. Italia, për shembull, e ka shprehur pozicionin e saj përmes ministrit të Jashtëm. Antonio Tajani komentoi: “Duke thënë që fjala ‘urrejtje’ nuk më pëlqen dhe nuk është pjesë e fjalorit tim, dua të kujtoj se ne i mbrojmë vetë anijet tona

tregtare, me Marinën tonë Ushtarake që ka rrëzuar disa dronë të lëshuar nga Houthi-t. Ndoshta Vance, që është i sapo ardhur në detyrë, nuk e njeh mirë kontekstin, por ne jemi pjesë e disa operacioneve bashkë me SHBA-në dhe Mbretërinë e Bashkuar”. Angela Rayner, zëvendëskryeministrja britanike, tha se «u takon Shteteve të Bashkuara të sqarojnë deklaratat e bëra në privat», por përsëriti forcën e marrëdhënieve me SHBA-në. Ndërkohë, Mike Martin, anëtar i Komisionit të Mbrojtjes, ishte më pak diplomatik: “Zëvendëspresidenti amerikan dhe sekretari i Mbrojtjes e urrejnë Evropën, ndërsa përpiqen t’i nxjerrin para”. Qeveritë evropiane kanë

tentuar ta ulin tonin. Qeveria gjermane u mjaftua të thotë se “ka lexuar lajmet”. Ndërkohë, gjenerali francez Michel Yakovleff, që ka punuar për NATO-n, i quajti autorët e chat-it një “tufë idiotësh të paaftë dhe arrogantë”. Politikat e administratës Trump po shfaqen gjithnjë e më qartë. Në një podcast të fundit, i dërguari për Lindjen e Mesme dhe Ukrainën, Steve Witkoff, mbështeti idenë se ekonomitë e Gjirit mund të zëvendësojnë ato evropiane. “Ato mund të jenë shumë më të fuqishme. Evropa e sotme është jofunksionale”. Moderatorin, Tucker Carlson, mik i ngushtë i Trump-it, shtoi: “Do të ishte mirë për botën, sepse Evropa po vdes”. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Të premten hapet ekspozita për historikun e suksesit të xhudos së Kosovës

Federata e Xhudos e Kosovës (FXhK) ka njoftuar se të premten do ta organizojë ekspozitën “Përpyjekja e artë - rrugëtimi i xhudos në lartësimin e Kosovës”. Ekspozita hapet në orën 19:00

dhe mbahet në Galerinë e Fakultetit të Arteve në Prishtinë. Sipas njoftimit, kjo ekspozitë është një udhëtim në historinë e lavdishme të xhudos, të ndërtuar mbi përpjekjet e përditshme

shumëvjeçare, me mund dhe dashuri për xhudon dhe Kosovën. “Ajo është thurje e dimensioneve historike dhe të tanishme; nga përvojat personale te sukseset kolektive, të cilat paraqiten në

një përmbledhje imazhesh vizuale. Ekspozita zbulon copëza të një jete kushtuar xhudos, një rrugë të ndërtuar me sakrificë drejt triumfeve të mëdha. Sukseset historike të xhudos bartin emra

individualë, dhe nga medaljet e tyre u lartësua Kosova”, thuhet në njoftimin e FXhK-së. Ekspozita “Përpyjekja e artë - rrugëtimi i xhudos në lartësimin e Kosovës” është kuruar nga Berat Bajrami.

Drita dhe Gjilani duan fitore në derbi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 MARS - Dy skuadrat me traditë të madhe në futbollin e Kosovës, Drita dhe Gjilani, do të përballen sot (e enjte) në derbin me rivalitet më të madh në vend. Java e 26 e elitës së futbollit të Kosovës fillon me derbin e skuadrave gjilanasë, të cilat duan të shënojnë fitore në këtë përballje të jashtëzakonshme.

Futbollisti i Dritës, Rron Broja, ka thënë se janë të gatshëm për t'i mposhtur rivalët lokalë dhe për t'iu afruar edhe më shumë titullit të kampiones në Superligë. “Do të jetë një ndeshje derbi. Për dy javë jemi munduar ta përgatitemi siç është më se miri. Do të jetë një ndeshje e luftuar nga të dyja skuadrat, por jemi të gatshëm për çdo sfidë dhe me mund dhe angazhim do t'i marrim tri pikë që do të na gëzojnë neve dhe tifozët. Nuk jemi të relaksuar, por do të mundohemi ta mbyllim sa më shpejt kampionatin duke e siguruar titullin”, ka thënë Broja.

Drita është e para në renditjen tabelore me 54 pikë të grumbulluara, derisa Gjilani zë vendin e katërt me 35 pikë. Për ndeshjen që zhvillohet sot në Gjilan foli edhe futbollisti i dëshmuar në futbollin e Kosovës, Armend Thaqi. Ky i fundit pret që Gjilani t'iu rikthehet rezultateve pozitive, pasi në dy ndeshjet e fundit nuk ka arritur fitore. “Është një derbi me rivalitet të madh. Edhe ne si futbollistë jemi të nderuar që jemi



pjesë e një derbi kaq të madh por, përveç kënaqësisë, është edhe përgjegjësi e madhe. Pas dy javësh pushim vijmë dhe pas dy rezultateve jo të mira, tash jemi përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje për t'iu rikthyer ecurisë pozitive”, ka thënë Thaqi.

Dy ndeshje të tjera do të zhvillohen

të premten. Do të takohen Suhareka dhe Malisheva. Në mbrëmje Prishtina e pret Feronikelin '74. Të shtunën mbyllet kjo xhiro me dy ndeshje, ku spikat derbi në mes të Llapit dhe Ballkanit, që zhvillohet në stadiumin “Zahir Pajaziti”, ndërsa në ndeshjen tjetër takohen Ferizaj dhe Dukagjini.

SHKURT

Sylvinho, ndër trajnerët më të suksesshëm të Shqipërisë

Fitorja ndaj Andorrës ishte e 10-ta për selektorin Sylvinho në krye të kombëtares së Shqipërisë. Tekniku brazilian është ngjitur në vendin e katërt sa iu përket trajnerëve më të suksesshëm të kombëtarja kuqezi. Sylvinho është vetëm një hap larg vendit të tretë, të cilin e mban Hans Peter Brigel që regjistroi 11 fitore, ndërsa dy vendet e para mbahen nga Gianni De Biasi dhe Edy Reja. Ky i fundit regjistroi 14 fitore dhe mund të arrihet nga Sylvinho, me këtë të fundit që në verë rinovoi kontratën me Shqipërinë dhe ka ndeshje për të luajtur. Në krahun tjetër, De Biasi duket shumë larg. Italiani regjistroi plot 21 fitore me kuqezinjtë, ndërsa arriti edhe një kualifikim historik, si ai në Evropianin e vitit 2016.

Mësohen tetë ekipet finaliste të Kampionatit Evropian U-17 ‘Shqipëri 2025’

Shqipëri, Gjermani, Francë, Portugali, Çeki, Belgjikë, Angli dhe Itali janë tetë ekipet finaliste të Kampionatit Evropian U-17 “Shqipëri 2025”. Pas përfundimit të raundit të dytë të kualifikuesve në Ligën A, shtatë vendet e para të çdo grupi siguruan pjesëmarrjen në finale, ku do të luftojnë së bashku me Shqipërinë si vend organizator për trofeun e Kampionatit Evropian U-17. Të hënën, më 31 mars, në orën 19:00, në “Shtëpinë e Futbollit” do të hidhet shorti i Kampionatit Evropian U-17. Skuadrat do të ndahen në dy grupe me nga katër ekipe dhe do të përcaktohet kalendari i ndeshjeve. Kampionati Evropian U-17 “Shqipëri 2025” do ta ngrejë siparin më 19 maj, ndërsa finalja e madhe do të luhet më 1 qershor.

Kurti: Do të bëhen mbi 250 milionë euro investime në infrastrukturën sportive

Prishtinë, 26 mars - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës ka thënë se do të investohen 250 milionë euro investime në infrastrukturë sportive, duke përfshirë edhe Stadiumin Nacional. Ai ka shprehur besimin se brenda pak vitesh Kosova do ta ketë infrastrukturën më të mirë në

rajon. “Do ta organizojmë ngjarjen më të madhe sportive në histori të vendit, Lojërat Mesdhetare 2030, për të cilat do të bëhen mbi 250 milionë euro investime në infrastrukturë sportive. Veçanërisht me intensitet të lartë do të punohet për rregullimin e infrastrukturës së futbollit me 200 milionë euro për 20 stadione anembanë

vendit. Vendi ynë do ta ketë infrastrukturën më të mirë të futbollit në rajon, duke përfshirë edhe Stadiumin Nacional”, ka thënë Kurti. Lojërat Mesdhetare në Kosovë do të organizohen në verën e vitit 2030 dhe se, përveç stadioneve, pritet që të ndërtohen edhe shumë palestra sportive dhe pishina olimpike.



Verstappen: Për fitoren e parë sezonale na duhet shumë punë, por jemi konkurrues

LONDËR, 26 MARS - Max Verstappen nuk arriti dot të ngjitej në podium në garën e fundit të Formulës 1 zhvilluar në Kinë. Pasi u parakalua nga dy makinat Ferrari gjatë garës, ai arriti t'i rifitojë pozicionet, por pa mundur dot të shkojë më shumë se

vendi i katërt. Piloti i Red Bullit nuk e humbi buzëqeshjen para mikrofonave pavarësisht një gare që u përmirësua vetëm drejt fundit. “Thjesht mendoj të jap gjithçka kur hipi në makinë dhe kaq. Po e shijoj jetën dhe jam shumë i qetë”,

u shpreh katër herë kampioni i botës. “Fakti që ishim të shpejtë në fundin e garës më jep pak optimizëm dhe shpresë. Sa më shumë që zgjatej gara aq më kompetitivë ishim në pistë. Gjithsesi, për fitoren do të duhej shumë punë, por ishim

konkurrues”, ka deklaruar Max Verstappen. “Tani kemi 10 ditë pushim deri në garën e radhës në Japoni. Shpresojmë të jemi më konkurrues në atë garë dhe të arrijmë të rikuperojmë disi ndaj McLarenin”, u shpreh piloti holandez.



Vinicius Jr. dhe Marquinhos: Brazili luajti shumë keq, s'duam ta humbasim Botërorin

SAO PAULO, 26 MARS - Ylli i Real Madridit, Vinicius Jr., nuk e fshehu zhgënjimin pas humbjes së Brazilit ndaj Argjentinës (1-4) në kualifikueset e Amerikës së Jugut për Kupën e Botës 2026 dhe kërkoi ndryshime në kombëtare. “Të martën hymë në dhomat e zhveshjes dhe nuk kishte shumë për të thënë. Duhet vetëm të reflektojmë mbi atë që bëmë në fushë, luajtëm shumë keq dhe Argjentina zhvilloi një ndeshje të shkëlqyer para tifozëve. Duhet të rishqyrtojmë gjithçka që po bëjmë”, ka thënë Vinicius Jr. Marquinhos, kapiten i Brazilit, i cili ka bërë me dije se skuadra duhet të bëjë shumë më mirë dhe se faji nuk mund t'i atribuohet vetëm trajnerit Dorival Junior. “Na mbetet vetëm një vit deri në Kupën e Botës. Kam luajtur një Botëror dhe nuk dua ta humbas sërish”, ka nënvizuar ylli brazilian. “Duhet të bëjmë shumë gjëra



ndryshe, por edhe t'i vazhdojmë gjërat e mira që po bëjmë për të ndërtuar një ekip të madh. Të gjithë e dinë peshën e kësaj fanelle, vështirësitë që sjell... Duhet të përmirësohemi, të ecim përpara me kokën lart. Nuk dorëzohemi kurrë. Do të kualifikohemi për Kupën e Botës”, ka shtuar ai. “Besoj se

Argjentina ka shumë vjet punë pas. Ka lojtarë që luajnë prej kohësh bashkë dhe fituan Kupën e Botës së fundit. Ne po përpiqemi ta gjejmë mënyrën tonë të lojës dhe të krijojmë besim te tifozët. Puna është e gjatë dhe duhet të vazhdojmë të përmirësohemi”, ka deklaruar Marquinhos.

Oklahoma e pandalshme, mposht Sacramenton

SACRAMENTO, 26 MARS - Oklahoma mbetet skuadra më e mirë në NBA, duke mposhtur me rezultat 121-105 Sacramenton. Tjetër ndeshje e mirë e Alexander Shait, që realizoi 32 pikë. Fitoi edhe skuadra e New York, 128-113 ndaj Dallasit, ndeshje ku dyshja Anunoby-Towns realizoi 61 pikë. Clevelandi mbetet skuadra më e mirë në Lindje, duke fituar me



rezultat 122-111 ndaj Portlandit. Garland me 27 pikë e Jerome me 25 pikë bënë dallimin në fushë. Fitoi edhe Detroiti, 122-96 ndaj San Antonios, me Marcus Sasser protagonist, autor i 27 pikëve. Rikthehet te fitorja Miami, që mundi me rezultat 112-96

Golden Staten. Adebayo me 27 pikë ishte më i miri në fushë, ndërsa për Warriorsin mungoi lojtari-lider. Triumfoi edhe Houstoni, 121-114 ndaj Atlantias (Green 32 pikë), ndërsa Orlando mundi me shifrat 111-104 Charlotten (Banchero 32 pikë).

REZULTATET

Charlotte - Orlando	104-111
Detroit - San Antonio	122-96
Miami - Golden State	112-86
New York - Dallas	128-113
Houston - Atlanta	121-114
Utah Jazz - Memphis	103-140
Portland - Cleveland	111-122
Sacramento - Oklahoma	105-121

SHKURT

Manaj në garë për çmimin ‘Lojtari i Raundit të Dytë’

Rey Manaj ishte protagonist kryesor në fitoren e Shqipërisë 3-0 ndaj Andorrës në “Arenën Kombëtare”. Sulmuesi kuqezí shënoi dy gola të bukur që në pjesën e parë të takimit dhe është përzgjedhur nga UEFA si një nga kandidatët e mundshëm për ta fituar çmimin e Lojtarit të Raundit të Dytë të kualifikuesve, të vlefshme për Kupën e Botës. Së bashku me Rey Manajn në garë për këtë çmim të veçantë janë edhe Karol Swiderski i Polonisë, Martin Odegaard i Norvegjisë dhe Haris Hajradinović i Bosnjë-Hercegovinës. Votimi është hapur në faqen e UEFA-s dhe të gjithë tifozët mund të votojnë. Procesi i votimit do të jetë i hapur deri ditën e nesërme në orën 15:00 dhe më pas UEFA do ta shpallë lojtarin më të mirë të raundit të dytë.

Kupa e Botës për klube, fituesin e pret një shpërblim marramendës

Kanë mbetur edhe pak muaj deri në fillimin e Kupës së Botës për klube. Është hera e parë që në Kupën e Botës për klube do të marrin pjesë 32 skuadra nga e gjithë bota. Real Madridi, Bayern Munichu, Borussia Dortmundi, Chelsea, PSG-ja, Atletico Madridi, Red Bull Salzburgu, Manchester City, Juventus, Interi, Benfica dhe Porto janë skuadrat evropiane që do të marrin pjesë. E fituesin e Kupës së Botës për klube e pret një shpërblim jashtëzakonisht i madh. Sipas BBC-së, fituesi i Kupës së Botës për Klube këtë verë do të fitojë 125 milionë dollarë në total, ku 40 milionë vijnë vetëm nga fitorja e finales. Kjo pretendohet të jetë shuma më e madhe e parave në futbollin e klubeve në një format me shtatë ndeshje.

Davies mungon 6 muaj

Ylli i Bayern Munchenit, Alphonso Davies dhe i kombëtares kanadeze, ka pësuar një dëmtim të rëndë në ligamentin kryqëzor të gjurit (ACL). Sipas raportimeve nga “BILD”, ai pritet të jetë jashtë lojës për rreth 6 muaj, dhe kështu ky lëndim do ta lë jashtë fushës për pjesën e mbetur të sezonit. Ky është një lajm i rëndë për Bayern Munchenin që po lufton në tri fronte këtë sezon.

Modriqi do të largohet nga Reali, por jo nga La Liga

Luka Modriqi me shumë mundësi po luan sezonin e fundit me fanellën e Real Madridit. 39-vjeçari po përgatitet për t'u ndarë me “Los Blancos” në fund të këtij sezoni. Ndërkohë, “Defensa Central” raporton një lajm vërtet të bujshëm, ku thuhet se Luka Modriqi do të largohet nga Reali, por jo nga La Liga. Klubi i Villarrealit po tenton ta bindë kroatin për ta veshur fanellën e tij për sezonin e ardhshëm. “Nëndetësja e Verdhë” beson se, pavarësisht prej moshës së tij, kroat ende mund ta bëjë dallimin në fushë dhe ta ndihmojë t'i arrijë objektivat. Nga ana tjetër, Modriqi synon të jetë në gjendje të mirë fizike për Botërorin 2026 dhe propozimi i Villarrealit është shumë interesant për të, por ende nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Për kroatin ka interesim të madh edhe nga klubet arabe si dhe nga ato të MLS-së, por duke qenë se dëshiron të jetë në formë për Kupën e Botës, e cila do të jetë e fundit për të, qëndrimi në La Liga duket si mundësia ideale për të.

PSG-ja pritet t'i largojë pesë futbollistë

PSG-ja planifikon të shesë disa lojtarë të profilit të lartë në afatin kalimtar të verës, sipas “El Nacional”. Klubi parisien është në dijeni se

disa lojtarë duan të largohen nga Parku i Princave, derisa disa të tjerë nuk janë në planet e tyre. Mediumi bën me dije se trajneri Luis

Enrique dëshiron ta pastrojë listën, me pesë lojtarë që nuk janë në planin e tij. Gianluigi Donnarumma, Goncalo Ramos, Randal Kolo Muani,

Lucas Hernandez dhe Marco Asensio (aktualisht i huazuar në Aston Villa) që janë viktimat e mundshme. Pas 26 xhirove të Ligës 1, PSG-ja

qëndron në vendin e parë me 68 pikë. Në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, klubi francez do të përballet me Aston Villën.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 36 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.275 dhe nr. 313 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

Pozita: Këshilltar Juridik për Çështje Juridike dhe Përfaqësim Gjyqësor
Numri i referencës: KJPGJ/ZKA/06-03/25
Grada: ZKA-X2
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat Kryesore:

- Ofron këshilla profesionale, opinione ligjore dhe rekomandime gjatë auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë sipas akteve të brendshme, udhëzuesve dhe doracakëve në fuqi;
- Merr pjesë në auditimet e pajtueshmërisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA), legjislationit në fuqi dhe akteve të brendshme të ZKA-së dhe mbështet ekipet e auditimit, sipas kërkesës;
- Ofron asistencë ligjore dhe udhëzon ekipet e auditimit për çështjet e pajtueshmërisë;
- Shfrytëzon njohuritë juridike për të dhënë këshilla të sakta në lidhje me përputhshmërinë ligjore gjatë auditimit, si dhe për të identifikuar rreziqet dhe shkeljet potenciale;
- Siguron shkrim të rrjedhshëm të dokumenteve të punës për pajtueshmëri duke nxjerr konkluzione këshilla/rekomandime të qarta për çështjet e trajtuara që mund t'i ndihmojnë ekipit të auditimit;
- Merr pjesë në hartimin e akteve juridike, dokumente strategjike, marrëveshje bashkëpunimit dhe akteve tjera nga fushëveprimtaria e ZKA-së, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me dispozitat kushtetuese, legjislationin në fuqi dhe SNISA-t, dhe respekton teknikat dhe standardet e hartimit sipas legjislationit në fuqi;
- Mbikëqyrë zbatimin e akteve juridike të ZKA-së, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me legjislationin në fuqi dhe SNISA-t. Identifikon zbrazësitë juridike, mangësitë dhe vështirësitë në zbatimin e tyre, si dhe propozon ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e situatës;
- Përfaqëson dhe/ose bashkëpunon me strukturat institucionale në përfaqësimin ligjor të ZKA-së, si dhe trajton ankesat dhe parashtrës nga Gjykatat e Republikës së Kosovës dhe institucioneve të tjera relevante;
- Publikon aktet nënligjore të ZKA-së në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe përditëson regjistrin e ankesave dhe parashtrësve, si dhe
- Kryen detyra tjera të përcaktuara me legjislationin në fuqi dhe të ngarkuara nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo i niveleve tjera më të larta në hierarki.

Kërkesat e përgjithshme formale, janë:

- Arsimimi: Diplomë të fakultetit juridik;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në çështje juridike, administratë apo auditim.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislationit dhe akteve tjera juridike.
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit.
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion.
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point).

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislationin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **11.04.2025 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, kao i Člana 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije, vezano sa Članom 36 Pravilnika (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji radnih mesta; Godišnjem planu regrutacije za 2025. godinu, kao i Odlukom Generalne revizorke br.275 i 313, za popunu slobodnog radnog mesta Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS
za popunjavanje slobodnog radnog mesta

Pozicija: Pravni savetnik za pravna pitanja i sudsko zastupanje
Referentni broj: KJPGJ/ZKA/06-03/25
Rang: ZKA-X2
Broj pozicija: Jedna (1)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Glavni zadaci:

- Pruža profesionalne savete, pravna mišljenja i preporuke tokom finansijske revizije i revizije usklađenosti prema internim aktima, Smernicama i priručnicima na snazi;
- Učestvuje u revizijama usklađenosti u skladu sa Međunarodnim standardima vrhovnih institucija revizije (MSVIR), važećim zakonodavstvom i internim aktima NKR-a i podržava revizorske timove, po zahtevu;
- Pruža pravnu pomoć i upućuje revizorske timove o pitanjima usklađenosti;
- Koristi pravno znanje za davanje tačnih saveta u vezi usklađenosti sa zakonima tokom revizije, kao i za identifikaciju potencijalnih rizika i kršenja;
- Obezbedi tečno pisanje radnih dokumenata o usklađenosti izvlačenjem jasnih zaključaka, saveta/preporuka o adresiranim pitanjima koja mogu pomoći revizorskom timu;
- Učestvuje u izradi pravnih akata, strateških dokumenata, ugovora o saradnji i drugih akata iz delatnosti NKR-a, obezbeđujući usklađenost sa ustavnim odredbama, važećim zakonodavstvom i standardima MSVIR, i poštuje tehnike i standarde izrade u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- Nadgleda primenu pravnih akata NKR-a, obezbeđujući njihovu usklađenost sa važećim zakonodavstvom i standardima MSVIR. Identifikuje pravne praznine, nedostatke i poteškoće u njihovoj primeni, kao i predlaže preduzimanje konkretnih mera za poboljšanje situacije;
- Predstavlja i/ili sarađuje sa institucionalnim strukturama u pravnom predstavljanju NKR-a, i bavi se žalbama i podnescima od Sudova Republike Kosovo i drugih relevantnih institucija;
- Objavljuje podzakonske akte NKR-a u Službenom listu Republike Kosovo i ažurira registar žalbi i podnesaka, kao i
- Obavlja i druge poslove definisane važećim zakonima koje zadaje neposredni rukovodilac ili drugi viši nivoi u hijerarhiji.

Opšti formalni zahtevi, su:

- Obrazovanje: Diploma pravnog fakulteta;
- Profesionalno iskustvo: Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u pravnim pitanjima, administraciji ili reviziji.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u izradi, usaglašavanju zakonskih i drugih pravnih akata.
- Poznavanje pravnih akata koji se sprovode u Nacionalnoj kancelariji revizije.
- Veština u komunikaciji i planiranja rada.
- Istraživačke, analitičke, procenjivačke veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta.
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i rada pod pritiskom.
- Poznavanje rada na računaru softverskih aplikacija (Word, Excel, Power Point).

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Postupak prijave:

Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju predati sledeća potrebna dokumenta:

- službeni formular NKR-a za aplikaciju;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Penzionog fonda);
- potvrda iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa javne funkcije (ako se primenjuje);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenta dostavljena nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpuna će biti odbijena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **11.04.2025 do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. “Ahmet Krasniqi” br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 47 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.275 dhe nr. 313 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

Pozita: Lektor
Numri i referencës: LZKA/ZKA/07-03/25
Grada: ZKA-E9
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat Kryesore:

- Përgjegjës për sigurimin e cilësisë së lartë gjuhësore në të gjitha dokumentet që prodhon Zyra Kombëtare e Auditimit, duke përfshirë por jo kufizuar me raporte, shkresa zyrtare, vendime, udhëzime, komunikata dhe deklarata publike në gjuhën shqipe. Procesi përfshin rishikimin dhe redaktimin e teksteve për pasaktësi gramatikore, sintaksore dhe stilistike, duke siguruar që dokumentet rrjedhin në gjuhë të qartë, të thjeshtë dhe koncize, si dhe evituar mundësinë për keqinterpretime dhe dy kuptimësi.
- Përgjegjës për sigurimin e saktësisë, kohezionit dhe njëtrajtshmërisë në përdorimin e frazeologjisë dhe terminologjisë, në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e legjislacionit. Procesi mbetet thelbësor për të siguruar që gjuha e përmbytjes së dokumentit mbetet koherente dhe komunikohet në mënyrën e duhur.
- Përgjegjës për menaxhimin efikas të kohës, frymën e bashkëpunimit dhe ruajtjen e fokusit edhe nën presionin e afateve të ngushta. Procesi siguron përmbytjen e standardeve më të larta gjuhësore për nga cilësia dhe saktësia, pa komprometuar asnjërin aspekt.
- Përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të arkivimit të materialeve të lekturuara në përputhje me politikat e arkivimit.
- Angazhimi në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bibliotekës së materialeve referuese, përfshirë fjalorët, udhëzuesit për shkrim dhe burimet gramatikore, në bashkëpunim të ngushtë me përkthyesit.
- Përmbytja e detyrave të tjera sipas kërkesës dhe në përputhje me legjislacionin si dhe aktet normative në fuqi.

Kërkesat e përgjithshme formale, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në gjuhë dhe letërsi;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale.

Shkathësitë e kërkuara:

- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës.
- Shkathësi në organizim të punës dhe përmbytje të objektivave;
- Njohuri të Akteve Juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Aftësi motivuese dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

